



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1418 / 8 prot.

Datë 21.09.2021

**V E N D I M**

**Nr. 653/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “K-AKS” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF- 97731-06-08-2021, me objekt: “*Furnizim vendosje sisteme automatike parkimi për nevojat e Bashkisë Fier*”, me fond limit 4,150,000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 21.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
- Ankimues:** “PC Store” SHPK  
Adresa: Rruga “Dibrës”, Vila 153, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier  
Adresa: Rruga “Ramiz Aranitasi”, Lagjja “Kastriot”, Nr. 15, Fier.
- Subjekt i Interesuar:** “K-AKS” SHPK  
Adresa: Sukth, Durrws.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 24 e vijues  
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin*”

*e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.06.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF- 97731-06-08-2021, me objekt: “Furnizim vendosje sisteme automatike parkimi për nevojat e Bashkisë Fier”, me fond limit 4,150,000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 21.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datë 21.06.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.06.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si vijon:

1- “Fred Electronic” SHPK	2.868.800	leke	skualifikuar
2- “K-AKS” SHPK	3.775.670.05	leke	kualifikuar
3- “PC Store” SHPK	3.776.000	leke	kualifikuar

4- “Adi Profesional” SHPK

3.889.040 leke kualifikuar

II.4. Në datën 29.07.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE, me fitues shoqërinë “K-AKS” SHPK.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 02.08.2021 operatori ekonomik ankimues “PC Store” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më datë 30.07.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “K-AKS” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1418/2, datë 30.07.2021, lidhur me kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi “PC Store” SHPK, ka ngritur pretendime për sa i përket ofertës së shoqërisë “K-AKS” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 7205/4 prot, datë 11.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1418/3 prot datë 13.08.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “PC Store” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 1418/4 prot, datë 20.08.2021, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni Prokurimit Publik ju drejtua Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, duke kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

*Operatori ekonomik “K-AKS” SHPK me NIPT K52304503K, në datën 21.06.2021 ka pasur detyrime tatimore të papaguara si: 1- Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, 2-Tatim mbi Fitimin, 3- Tatim mbi Vlerën e Shtuar, 4- Tatim në Burim, etj.?*

*Për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi të na dërgoni informacionin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.*

II.9. Me shkresën nr. 9068/1 prot., datë 25.08.2021, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1418/5 prot, datë 31.08.2021 me objekt: “Kthim përgjigje shkresës protokolluar me tonën nr. 9068, datë 25.08.2021”, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës ka dërguar informacion me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Pas verifikimeve të kryera në sistemin informatik të tatimeve C@ts rezulton se tatimpaguesi K-AKS me nipt K52304503K sipas situatës së detyrimeve në kohë reale të datës 25.08.2021*

*ka detyrime të papaguara në shumën 815359 lekë Tatimin mbi Fitimin për të cilat ka lidhur marrëveshje për pagesë me këste të detyrimit prot me tonën nr. 4786, datë 05.05.2021. Periudhën e kërkuar nuk mund ta verifikojmë sepse sistemi C@ts nuk nxjerr raporte për detyrimet e një date të kaluar pasi sistemi bën veprime veterregulluese të cilat nuk mund të kthehen pas në kohë.*

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik. Me shkresën nr. 1418/6 prot., datë 13.09.2021, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion autoritetit kontraktor, në lidhje me argumentat e datës 03.08.2021 të paraqitura nga operatori ekonomik “K-AKS” SHPK

II.11. Me shkresën nr. 8412/1 prot., datë 14.09.2021, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1418/7 prot, datë 17.09.2021 me objekt: “*Dërgohet informacioni i kërkuar sipas shkresës tuaj nr. 1418/6, datë 13.09.2021 në lidhje me shqyrtimin e ankesës për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt: Furnizim vendosje sisteme automatike parkimi për nevojat e Bashkisë Fier*”, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion në lidhje me procedurën si dhe argumentat e operatorit ekonomik “K-AKA” SHPK.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “PC Store” SHPK, mbi kundërshtimin e k kualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...]Në lidhje me pikën 2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, ne përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. Në lidhje me këtë pikë kemi bindjen që OE “K-AKS” shpk nuk ka paraqitur vërtetim shlyerje të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga një kërkim në QKB rezulton që kompania në fjalë “K-AKS” SHPK ka këto adresa të ushtrimit të aktivitetit: 1- Durrës, 2- Tiranë, 3- Shkodër, 4- Lezhë, 5- Fier, 6- Vlorë, 8- Korçë. AK e ka anashkaluar këtë pikë duke mos marrë në konsideratë çfarë ka kërkuar tek DST dhe kualifikuar një OE që nuk ka plotësuar këtë pikë. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.2.3 , të shtojcës 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.3 “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “K-AKS” ShPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

*1- Vërtetim Nr. 7170 protokollit datë 16.06.2021 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës për shoqërinë “K-AKS” sh.p.k. me anë të së cilës vërtetohet se “Subjekti K-AKS me administrator z. K. K, me aktivitet prodhim me adresë Durrës, Sukth, i regjistruar pranë Drejtorisë së Taksave dhe tarifave Vendore, Bashkia Durrës, nuk ka detyrime të palikujduara deri në datën e marrjes së vërtetimit.*

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet

*në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 27, pikat 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

*2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*

*4. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose*

*b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose*

*ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.*

*Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

III.1.5. Neni 12 “Rregjistrimi dhe ndryshimet” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me*

*ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit [...]*

III.1.6. Neni 5 “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: *Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë:*

*a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;*

*b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;*

*c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;*

III.1.7. Neni 9 i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Në taksat vendore përfshihen:

*1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.*

*2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.*

*3. Taksa e fjetjes në hotel.*

*4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.*

*5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.*

*6. Shfuqizohet.*

*7. Shfuqizohet.*

*8. Taksa e tabelës.*

*9. Taksa të përkohshme.*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat, që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë në kuptim të këtij ligji.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor, që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të

paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020 ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin *Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi*. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "K-AKS" SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur *Vërtetimin Nr. 7170 protokollin datë 16.06.2021 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, nuk ka detyrime të palikujduara deri në datën e marrjes së vërtetimit*, ndërkohë nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar të subjektit "K-AKS" SHPK rezulton se ky operator ekonomik ushtron aktivitetin në selinë qendrore pranë Bashkisë Durrës, si dhe në Bashkitë Tiranë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Vlorë, etj. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "PC Store", si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "K-AKS" në sistemin e prokurimeve elektronike në lidhje me përmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.2.3, rezulton se nuk ka paraqitur për të gjitha vendet ku ushtron veprimtarinë tregtare, vërtetimet e shlyerjes së taksave dhe tarifave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "K-AKS" SHPK në përmbushje të këtij kriteri, ky i fundit ka dorëzuar vërtetime lëshuar nga Bashkia Durrës me anë të të cilit konfirmohet, se ofertuesi nuk ka detyrime të papaguara lidhur me taksat dhe tarifave vendore për vitin 2020 për këtë Bashki. Nga verifikimi i ekstraktit të regjistrimit tregtar të ofertuesit të paraqitur rezulton, se ky i fundit ka ushtruar aktivitet ekonomik për vitin 2020



edhe në Bashkitë Tiranë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Vlorë, fier, Kavajë, për të cilat nuk ka paraqitur vërtetimet përkatëse. Në këtë kuptim Komisioni gjykon, se pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik “K-AKS” SHPK, janë të bazuara dhe në përputhje me kriteret e kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka vlerësuar ofertat e operatorëve ekonomikë në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit. Qëllimi dhe fryma e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, detyron subjektet të regjistrojnë vendet ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Operatori ekonomik “K-AKS” SHPK për vitin 2020 rezulton të ketë ushtruar aktivitet edhe në Bashkitë Tiranë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Fier, Kavajë, vende këto të ushtrimit të aktivitetit për të cilat nuk ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me Manualin nr 1, datë 26.01.2018 “Për Regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimeve elektronik”, vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, por ka ngarkuar vetëm vërtetimin me nr. 7170 protokollin datë 16.06.2021 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, nuk ka detyrime të palikujduara deri në datën e marrjes së vërtetimit, duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me kriteret për kualifikim për dorëzimin e vërtetimeve për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha vendet ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitet sipas ekstraktit të QKB. Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “K-AKS” SHPK nuk ka dorëzuar dokumentacion të plotë për përmbushjen e kriterit, pasi nuk ka ngarkuar në SPE të gjitha vërtetimet ku ai ushtron aktivitet sipas ekstraktit të QKB, gjithashtu edhe vërtetimet e sjella nëpërmjet informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr 8412/1 prot, datë 14.09.2021. Vërtetimet bashkëlidhur informacionit nuk pasqyrojnë gjendjen e operatorit ekonomik, para datës së dorëzimit të dokumenteve në sistemin e prokurimeve elektronike, pasi nga shqyrtimi i tyre rezulton se ato mbajnë datë të mëvonshme nga data e zhvillimit të procedurës në SPE.

Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve sipas përcaktimeve të bëra në Manualin nr 1, datë 26.01.2018 “Për Regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimeve elektronik”, ku përcaktohet se: [...] *Para se të filloni me ngarkimin e dokumentave, duhet të siguroheni që të gjithë dokumentat të jenë të konvertuara në mënyrë elektronike në formatin .pdf në kompjuterin tuaj. Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar. Versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për një procedurë prokurimi konkrete është i barazvlefshëm me dokumentin origjinal, ose kopjen e noterizuar. Kujdes: Në sistem mund të ngarkoni vetëm në formatin pdf. Madhësia e tyre nuk duhet të jetë më shumë se 30 MB. Emërtimet e tyre të jenë pa simbole të veçanta (!, @, #, \$...etj), si dhe pa numra. Për të filluar me procesin e ngarkimit e dokumentacionit në sistem, pasi keni klikuar mbi procedurën e gjetur tek skedari “Procedura të Publikuara” apo tek skedari “Marrëveshje Kuadër”, duhet të klikoni butonin “Hapi tjetër”. Procesi i krijimit të ofertës në sistem është i ndarë në 4 dritare (seksione). Në dritaren e dytë ju shfaqet*

*Seksioni “Ngarko dokumentat e faktit”. Në këtë dritare operatori ekonomik, duhet të ngarkojë dokumentat përkatëse duke klikuar mbi butonin “Shto Dokument”. Në këtë moment, dritarja do të mbyllet dhe në seksionin dokumentat e faktit, do të shfaqet dokumenti i ngarkuar[...].*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “PC Store” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “PC Store” SHPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “K-AKS” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron, pasi operatori ekonomik “K-AKS” SHPK nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyesimit të KPP do të ndryshojë duke e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do e ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik “K-AKS” SHPK, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF- 97731-06-08-2021, me objekt: “Furnizim vendosje sisteme automatike parkimi për nevojat e Bashkisë Fier”, me fond limit 4,150,000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 21.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “K-AKS” SHPK duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**